



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.70, datë 27.08.2026

“PËR DHËNIEN FINANCIARE PËR FATKEQËSINË NATYRORE NË BANESËN E Z.YMER SULAJ FSHATI ZALOSHNE, NJËSIA ADMINISTRATIVE GJERBËS, BASHKIA SKRAPAR”.

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 27.08.2026, mori në shqyrtim projektaktin e mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.45/2019, “ Për mbrojtjen civile”, VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Skrapar nr.33, datë 23.11.2023 si dhe në vijim të rekomandimit të përsëritur të Zyrës së Avokatit të Popullit, Sektori për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, me shkresën nr.K5/Y2-6 Prot, datë 22.06.2026, drejtuar Bashkisë Skrapar,

VENDOSI:

Miratimin e dhënies së menjëhershme financiare nga fondi i Emergjencave Civile, për familjen e z.Ymer Sulaj, fshati Zaloshnje, Njësia Administrative Gjerbës, në vlerën 635.019(gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëmbëdhjetë) lekë, për mbulimin e diferencës së preventivit të mbetur pa u likujduar për dëmet e shkaktuara në banesë nga reshjet e mëdha të shiut.

Vendimi u miratua me 9 Vota pro, vota kundër - s’ka , abstënim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

